

# Statistikat e kulturës

## Tremujori III– 2019

**Tiranë, më 1 Nëntor 2019:** Numri i shfaqjeve kulturore gjithsej në tremujorin e tretë 2019 është 61, duke pësuar një rënie prej 11,6 %, në krahasim me tremujorin e tretë 2018. Në institucionet qendrore të artit dhe kulturës, në tremujorin e tretë të vitit 2019, janë organizuar 11 premiera, një premierë më shumë, në krahasim me tremujorin e tretë 2018.

Në tremujorin e tretë 2019, numri i spektatorëve është 12.558, duke pësuar rënie me 54,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Pjesëmarrja mesatare në tremujorin e tretë 2019 është 206 spektatorë për shfaqje, nga 401 spektatorë të rezultuar në tremujorin e tretë 2018.

### Institucione qendrore të artit dhe kulturës

Në tremujorin e tretë 2019, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë është institucioni që ka realizuar numrin më të lartë të shfaqjeve gjithsej, me 30 të tilla, 14 shfaqje më shumë, krahasuar me tremujorin e tretë 2018. Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor ka realizuar numrin më të lartë të premierave, 6 premiera, një më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Tab.1 Numri gjithsej i shfaqjeve/premierave në institucionet kulturore**

Numri i shfaqjeve/premiera	Shfaqje		Premiera		Gjithsej		Ndryshimi tremujor në %
	Tr.3-2018	Tr.3-2019	Tr.3-2018	Tr.3-2019	Tr.3-2018	Tr.3-2019	
Teatri Kombëtar Popullor	13	0	2	0	15	0	-100
Teatri Kombëtar Eksperimental	14	10	2	4	16	14	-12,5
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	3	5	5	6	8	11	37,5
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	15	29	1	1	16	30	87,5
Cirku Kombëtar	14	6	0	0	14	6	-57,1
<b>Shfaqje kulturore/premiera gjithsej</b>	<b>59</b>	<b>50</b>	<b>10</b>	<b>11</b>	<b>69</b>	<b>61</b>	<b>-11,6</b>


Në tremujorin e tretë 2019, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor për arsye rikonstruksioni ka dhënë shumë shfaqje të hapura. Ndërkohë tabela e spektatorëve përfshin vetëm spektatorët në shfaqje të mbyllura.

**Tab.2 Numri gjithsej i spektatorëve në institucionet kulturore**

Numri i spektatorëve	Tr.3-2018	Tr.3-2019	Ndryshimi tremujor në %
Teatri Kombëtar Popullor	5.748	0	-100,0
Teatri Kombëtar Eksperimental	3.327	2.344	-29,5
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	6.600	6.200	-6,1
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	2.250	3.014	34,0
Cirku Kombëtar	9.721	1.000	-89,7
<b>Numri i spektatorëve gjithsej</b>	<b>27.646</b>	<b>12.558</b>	<b>-54,6</b>

Për shkak të mungesës së shfaqjeve në Teatrin Kombëtar Popullor, pjesëmarrja mesatare e spektatorëve për shfaqje, në të gjithë institucionet kulturore, gjatë tremujorit të tretë të 2019 ka pësuar një rënie në masën 48,6 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë.

**Fig.1 Pjesëmarrja mesatare e spektatorëve për shfaqje të mbyllura në institucionet kulturore**



### Trashëgimia kulturore


Numri i vizitorëve gjithsej në muze, kala dhe parqe arkeologjike, në tremujorin e tretë 2019 është 518.365 vizitorë, duke shënuar një rritje me 8,9 %, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit të kaluar. Nga totali i vizitorëve në institucionet e trashëgimisë kulturore, 129.354 janë vizitorë në muze, 162.429 vizitorë në kala e monumente të tjera dhe 226.582 janë vizitorë në parqe arkeologjike.

Në tremujorin e tretë 2019, numri i vizitorëve gjithsej të huaj në muze, kala dhe parqe arkeologjike ishte 316.835, duke shënuar një rritje me 6,0 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2018. Gjatë tremujorit të tretë 2019, në të gjithë institucionet e trashëgimisë kulturore vihet re një përqindje më e lartë e vizitorëve të huaj, krahasuar me vizitorët vendas.

**Tab.3 Vizitorë në muze, kala dhe monumente të tjera, parqe arkeologjike**

Institucionet e trashëgimisë kulturore	Numri i vizitorëve vendas			Numri i vizitorëve të huaj			Numri i vizitorëve gjithsej		
	Tr.3-2018	Tr.3-2019	Ndryshimi tremujor në %	Tr.3-2018	Tr.3-2019	Ndryshimi tremujor në %	Tr.3-2018	Tr.3-2019	Ndryshimi tremujor në %
Muze	40.368	44.121	9,3	74.353	85.233	14,6	114.721	129.354	12,8
Kala e Monumente të tjera	52.521	63.431	20,8	102.129	98.998	-3,1	154.650	162.429	5,0
Parqe Arkeologjike	84.218	93.978	11,6	122.462	132.604	8,3	206.680	226.582	9,6
<b>Gjithsej</b>	<b>177.107</b>	<b>201.530</b>	<b>13,8</b>	<b>298.944</b>	<b>316.835</b>	<b>6,0</b>	<b>476.051</b>	<b>518.365</b>	<b>8,9</b>

**Fig.2 Përqindja e vizitorëve të huaj në muze, kala dhe monumente të tjera, parqe arkeologjike**



**Biblioteka Kombëtare**

Në tremujorin e tretë 2019, numri i shërbimeve të njëjësive bibliotekare është 27.590 njësi, 25,6 % më shumë, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2018.

Në tremujorin e tretë 2019, numri i frekuentuesve në Bibliotekën Kombëtare është 32.435, pothuajse dyfish më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në Bibliotekën Kombëtare, në tremujorin e tretë 2019 janë afishuar 544 tituj të rinj dhe 1.708 ekzemplarë të rinj.

**Tab.4 Frekuentimi dhe botimet në Bibliotekën Kombëtare**

Treguesit	Tr.3-2018	Tr.3-2019	Ndryshimi Tremujor në %
Shërbimi i njësive bibliotekare (njësi)	21.972	27.590	25,6
Frekuentimi	17.305	32.435	87,4
Veprimtari Kulturore dhe Shkencore	7	4	-42,9
Numri i hyrjeve të reja:			
Numri i titujve të rinj	422	544	28,9
Numri i ekzemplarëve të rinj	1.495	1.708	14,2

# Metodologjia

Të dhënat e statistikave të kulturës i referohen vetëm institucioneve qendrore cilat janë në varësi të nga Ministria e Kulturës. Në institucionet qendrore të artit e të kulturës përfshihen: Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli", Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave, dhe Cirku Kombëtar.

Në totalin e muzeve, kalave dhe parqeve arkeologjike janë përfshirë institucionet:

MUZE	KALA E MONUMENTE TË TJERË	PARK ARKEOLOGJIK
Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë	Kalaja Berat	Parku Kombëtar, Butrint
Muzeu Arkeologjik, Durrës	Kalaja Gjirokastrë	Parku Arkeologjik, Apoloni
Muzeu i Pavarësisë, Vlorë	Kalaja e Portopalmos	Parku Arkeologjik, Bylis
Muzeu Gjergj Kastrioti, Krujë	Kalaja e Kaninës	Parku Arkeologjik, Shkodër
Muzeu Etnografik, Krujë	Kalaja e Himarës	Parku Arkeologjik, Lezhë
Muzeu Etnografik, Berat	Amfiteatri	Parku Arkeologjik, Amantia
Muzeu Ikonografik Onufri, Berat	Manastiri i 40 Shenjtorëve	Parku Arkeologjik, Orikum
Muzeu i Artit Mesjetar, Korçë	Manastiri i Mesopotamit	Parku Arkeologjik, Finiq
Muzeu Arkeologjik, Korçë		Parku Arkeologjik, Antigone
Muzeu Arsimit, Korçë		
Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi		
Muzeu Kombëtar i përgjimeve " Shtëpia me Gjethe"		

## Përkufizime

*Trashëgimi kulturore* është tërësia e pasurive kulturore, materiale dhe jomateriale, të një individi, grupi ose shoqërie të trashëguar nga e kaluara që ruhet në të tashmen, për t'ua përçaruar brezave në të ardhmen si pjesë e pasurisë kombëtare të një vendi, të cilat shprehin vlerat identitetin, njohuritë, traditat, besimet, si dhe pasuritë kulturore të peizazhit.

*Muze* është institucioni i ruajtjes së kujtesës, në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, i hapur për publikun, që konservon, studion, komunikon dhe prezanton trashëgiminë e luajtshme e të paluajtshme të njerëzimit dhe mjedisit rrethues të tij, me qëllim edukimin, studimin, promovimin dhe argëtimin.

*Monument kulture* është objekti ose ndërtimi me vlera historiko-kulturore, që mbrohet nga shteti.

*Park arkeologjik* është territori i përcaktuar me kufij të qartë, që përfshin dëshmi të rëndësishme arkeologjike të mbitokës, nëntokës e nënujit dhe bashkëprani të pasurive historike, peizazhit kulturor, i organizuar me elemente të një muzeu në natyrë.

*Pjesëmarrja mesatare* e spektatorëve për shfaqje llogaritet me numrin total të spektatorëve në institucionet kulturore me numrin e shfaqjeve të realizuara në këto institucione.

*Bibliotekat* janë institucione kulturore dhe informuese, që realizojnë hyrje të lirë në informacion në cilëndo formë që ai të jetë depozituar. Ato grumbullojnë, ruajnë, përpunojnë dhe vënë në dispozicion të përdoruesve koleksionet e veta që përmbajnë informacion në shërbim të formimit të tyre.

*Frekuentimi* llogaritet me numrin e shërbimeve/materialeve bibliotekare që merr çdo frekuentues i bibliotekës kombëtare.

*Materiale bibliotekare* përfshijnë libra, artikuj, harta, disertacione, dhe materiale audiovizuale.

*Tituj të rinj* përfshijnë ato materiale bibliotekare që hyrjë në bibliotekë gjatë një periudhe referuese.

*Ekzemplarë të rinj* përfshijnë numrin e njësive bibliotekare për çdo titull të ri.